

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë prej gjyqtareve Kujtim Pasuli-kryetar i kolegjit dhe Nenad Llaziq e Gëzim Llulluni anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a Prishtine, kundër të paditurit F.N. nga Prishtina, për shkak të pagesës së borxhit, duke vendosur sipas ankesës të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1787/09 të datës 22.07.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit, **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1787/09 të datës 22.07.2014.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e goditur nën I të dispozitivit është aprovuar kërkesëpadija e paditësit si e bazuar. Nën II të dispozitivit është detyruar i padituri që paditësit në emër të përmbushjes së kontratës të paguaj shumën prej 165,63 €, me kamatë prej 3.5%, të cilën e paguajnë bankat komerciale për mjetet e deponuara pa destinim mbi një vit, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagimin përfundimtar, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 30 €, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i padituri, për shkak të;

- Shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe
- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ashtu që aktgjykimi i goditur të prishet dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ose të njëjtën ta ndryshoj.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, duke vepruar në kuptim të nenit 194 të Ligjit të procedurës kontestimore, ka vlerësuar aktgjykimin e goditur në kuadër të kufijve të arsyeve të theksuara në ankesë, duke pasur kujdes sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 e 2 si dhe zbatimit të drejtë të së drejtës materiale dhe gjeti se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka parashtruar padi me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që në emër të përmbushjes së kontratës të paguaj borxhin në shumë prej 135,63 €, me kamatë në lartësi prej 3.5%, si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë pasi që ka marr aktvendimin e të cilën ia ka dërguar bashkë me padi dhe provat e tjera të paditurit që të jep përgjigje në padi, dhe pasi që i padituri ka pranuar aktvendimin së bashku me padinë dhe provat e tjera dhe nuk ka dhënë përgjigje në padi, në kuptim të nenit 150 të LPK, ka marr aktgjykimin për shkak të padëgjueshmërisë, duke gjetur se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me nenin e lartcekur. Kjo për faktin se të paditurit i është dorëzuar padia për përgjigje së bashku me provat, themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi, faktet e treguara nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht dhe në rastin konkret faktet e treguara janë në harmoni me provat e dorëzuara. Vendimin si më lart gjykata e mbështetë edhe në dispozitën e nenit 262 par. 1 të LMD. Ndërsa për kamatën është vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 186 dhe 277 të LMD, ndërsa vendimi për shpenzimet e procedurës e mbështet në nenet 449 dhe 452 të LPK.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë në tërësi e pranon si të bazuar në ligj dhe qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë e pranon si të drejtë, pasi që aktgjykimi i goditur nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat shikon kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare, e në kuptim të nenit 194 e lidhur me nenin 182 paragraf 2 pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, e as në ato në të cilat thirret ankesa. Kjo Gjykatë gjen se theksimi ankimor se i padituri nuk është ftuar as njëherë në shqyrtim janë të pabazuara nga fakti se me shikimin në fletë kthesë e cila gjendet në shkresat e lëndës figuron qartazi se paditurit i është dërguar aktvendimi me ftesë që të jep përgjigje në padi së bashku me padinë dhe provat e tjera dhe se këtë e ka pranuar personalisht me dt. 14.04.2011, dhe nuk ka dhënë përgjigje, e për të cilën ka ekzistuar detyrimi i tij e në kuptim të nenit 395 par. 1, me të cilën dispozitë është paraparë se i padituri ka për detyrë që brenda afatit prej 15 ditësh të përgjigjet me shkrim në padi dhe pasi që i padituri nuk ka vepruar, atëherë gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka marr aktgjykimin për shkak padëgjueshmërisë e në kuptim të nenit 150 të LPK, pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet nga neni 150 par. 1 pika a), b) dhe c) të LPK.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare edhe për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, vlerësoj se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat, përkatësisht të drejtën materiale kur ka vendosur si në aktgjykimin e goditur, prandaj siç u cek edhe më lart pretendimet ankimore nuk ndikojnë në marrjen e vendimit ndryshe nga ajo që ka marr gjykata e shkallës së parë.

Prandaj, nga të paraqiturat ankesa e paditurit paraqitet si e pabazuar, dhe gjykata në kuptim të nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4657/2014 të datës 11.10.2017

Kryetar i kolegjit – gjyqtari
Kujtim Pasuli

PROCESVERBAL MBI KËSHILLIMIN DHE VOTIMIN

I përpiluar pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në seancën kolegjit të mbajtur me datë 11.10.2017

TË PRANISHËM JANË:

Kryetari i kolegjit-gjyqtari Kujtim Pasuli
Anëtarët e kolegjit-gjyqtarët Nenad Llaziq e Gëzim Llulluni

Duke vendosur sipas ankesës të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1787/09 të datës 22.07.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit, **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1787/09 të datës 22.07.2014.

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

1. **Nenad Llaziq**

Kujtim Pasuli

2. **Gëzim Llulluni**
